




Pranuar / Dërguar Punë/Prodato Received/Delivered	05-01	2024	4	viti god year
Organ / Shërbimi Org. / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. no.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOMSHOK	101/2024		1/16	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1522/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1438/2023 të datës 23.11.2023 të parashtruar nga ankuesja dhe ankesën me numër A.nr.1522/2023 të datës 14.12.2023 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë rruga të bashkuara sipas Vendimit të datë 29.12.2023 të Kryesuesit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në ankesën A.nr.1522/2023. kundër Vendimit me numër protokollit 974/02-KOM të datës 24.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 05.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1438/2023 e datës 23.11.2023 dhe ankesa me numër A.nr.1522/2023 e datës 14.12.2023 e parashtruar nga ankuesja të bashkuara sipas Vendimit të datë 29.12.2023 të Kryesuesit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në ankesën A.nr.1522/2023.

II. Anullohet Vendimi me numër protokollit 974/02-KOM i datës 24.11.2023 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Vendimi Ref.02/Nr.382 i datës 08.11.2023 i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesen në vendin e punës në pozitën "Udhëheqëse e Divizionit të Personelit" sipas Akt Emërimit të datës 30.01.2012 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me marrëdhënien e punës, duke bërë heqjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankueses.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 30.01.2012 në pozitën *Udhëheqëse e Divizionit të Personelit* në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 09.10.2023 ka paraqitur kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinore me arsyetimin për shkelje të rënda disiplinore si: "...mos përmbushje e detyrave të punës, neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës, mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës, moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale, veprimet apo mosveprimet të cilat kanë shkaktuar pasoja, vënien në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehje e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare", më konkretisht për sipas kësaj kërkesë inicimi i procedurës disiplinore ndërlidhet me: "Në cilësinë e ZKA dhe udhëheqësit të drejtpërdrejt më datë 19.06.2023 kam kërkuar nga dosjen e nëpunësit znj. K.T ku qëllimi i kësaj kërkesë ishte qëllimi i sigurimit që transferimi nga një pozitë në tjetrën është bërë sipas ligjit, ndërsa nuk ka dorëzuar këtë dosje dhe në bazë të emailit të datës 19.06.2023 ka dhënë sqarimet e paarsyeshme; neglizhon procesin e menaxhimit të zhvillimit profesional të zyrtarëve nuk është prezantuar nevoja e planit të trajnimit të zyrtarëve; Mosveprimi lidhur me procedurat e konkursit për vendet e lira të punës në MINT si dhe mosbashkëpunimi me udhëheqësit e agjencive/departamenteve lidhur me inicimin e procedurave të konkurseve për plotësimin e vendeve të punës; Nuk ka ndërmarr veprimet e nevojshme për sigurimin me kohë të dosjeve të personelit për Departamentin e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë të cilët i janë bashkuar MINT dhe nuk ka ndërmarr veprimet dhe nuk ka dhënë udhëzime për angazhim të zyrtarëve në të dy departamentet; Mosveprimi sipas kërkesës së komisioneve vlerësuese dhe trajnimit selektiv i ankesave të kandidatëve...si shkelej e të drejtave të kandidatëve duke mos ja pranuar ankesat e parashtruara dhe publikim i kandidatëve fitues pa përfunduar procedura sipas ligjit si dhe nxjerrja e informata të brendshme të kandidatëve jashtë të cilat informata kandidatët i kanë përmendur në ankesat e parashtruara në KPMSHCK; Refuzimi për vazhdim të procedurave të rekrutimit për pozitën për Inspektor të Tregut, refuzim me arsyetim të pabazuar pastaj vazhdim i të njëjtën por pa dhënë sqarime për ndalje të procedurës". Po ashtu zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 20.11.2023 ka parashtruar kërkesë për plotësimin e kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore të datës 09.10.2023, duke e ngarkuar ankesën edhe me shkelej të tjera disiplinore si: "Aprovimi i pushimeve mjekësore/lëndim profesionale pa ndonjë bazë ligjore për z. A.M dhe zyrtarët e tjerë; Shpallja e konkursit në Departamentin e Investimeve me një drejtim për arsimim; Nxjerrja e vendime për transfer të përkohshëm të zyrtarëve pa njoftim

paraparak edhe pse për një gjë të tillë është njoftuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës; Mosveprimi lidhur me vendimin e Këshillit të Pavarur për rastin e I.E dhe vendimeve të tjera të Këshillit të Pavarur; Paraqitja në listën e pagave të stafit të Kabinetit të Ministres në kategorisë shtesa për kompensim jashtë orarit të punës edhe pse një gjë e tillë nuk qëndron për shkak se nuk është parashtruar kërkesë për kompensim shtesë”.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 08.11.2023 ka nxjerr Vendim Ref.02/Nr.382 përmes të cilës ka bërë transferimin e përkohshëm të ankueses për gjashtë (6) muaj në pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Licencim, Veprimtari me Naftë dhe Produkte të Naftës”.

Ankuesja kundër këtij vendimi, më datë 23.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 7074/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 24.11.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokoli 974/02-KOM përmes të cilit ankuesen e ka bërë përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore “Transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë”.

Ankuesja kundër Vendimit me numër protokoli 974/02-KOM të datës 24.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 14.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 7457/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për shkelje procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.11.2023 dhe 19.12.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministrie Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Ndërsa Këshilli më datë 04.12.2023 dhe 26.12.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Më datë 29.12.2023, Kryesuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, ka nxjerr vendim për bashkimin e ankesës me numër A.nr.1438/2023 e datës 23.11.2023 dhe ankesës me numër A.nr.1522/2023 e datës 14.12.2023 e parashtruar nga ankuesja në ankesën A.nr.1522/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 7457/2023 të datës 14.12.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 09.10.2023 për iniciimin e procedurës disiplinore; Kërkesën e datës 20.11.2023 për plotësimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore; Vendimin me numër protokoli 974/02-KOM të datës 24.11.2023 të Komisionit

Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Procesverbalin e datës 22.11.2023 të seancës së Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 09.10.2023 dhe 24.10.2023 për formimin e Komisionit Disiplinor; Akt Emërimit të datës 30.01.2012; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitë Udhëheqës i Divizionit të Personelit i datës 30.01.2012; Emailin e datës 19.06.2023 nga E.A për ankuesen; Emailin e datës 19.06.2023 nga ankuesja për E.A; Emailin e datës 18.02.2022 të ankueses lidhur me Planin Individual të trajnimeve për stafin e MINT; Formularin e Planit Individual të Personelit për vitin 2023; Listën e trajnimeve për vitin 2023; Emailin e ankueses të datës 27.02.2023, datës 06.03.2023, datës 20.03.2023, datës 22.03.2023, datës 23.03.2023, datës 28.03.2023, datës 03.04.2023, datës 04.04.2023, datës 07.04.2023, datës 08.04.2023, datës 14.04.2023, datës 19.04.2023, datës 28.04.2023, datës 03.05.2023, datës 04.05.2023, datës 05.05.2023, datës 08.05.2023, datës 10.05.2023, datës 11.05.2023, datës 12.05.2023, datës 17.05.2023, datës 18.05.2023, datës 19.05.2023, datës 23.05.2023, datës 24.05.2023, datës 26.05.2023, datës 29.05.2023, datës 06.06.2023, datës 08.06.2023 lidhur me ftesat për trajnime; Listën e konkurseve të shpallura gjatë vitit 2023; Emailin e datës 03.02.2023, 06.03.2023, 12.04.2023 nga R.B për K.K për bartjen e dosjeve të zyrtare të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë; Emailin e datës 27.09.2023 nga ankuesja për H.M dhe I.K; Konkursin me Nr. Reference: RN00009713 për pozitën Inspektor i Tregut; Emailin e datës 03.10.2022, 06.10.2022, 11.10.2022, 18.10.2022 nga ankuesja për L.H; Emailin e datës 04.10.2022, 10.10.2022 nga L.H për ankuesen; Emailin e datës 12.10.2022 nga V.R-V për L.H; Emailin e datës 17.10.2022, 14.10.2022 nga R.B për ankuesen; Emailin e datës 14.10.2022 nga ankuesja për R.B; Emailin e datës 18.10.2022 nga ankuesja për F.L; Emailin e datës 26.10.2022 nga L.H për F.L; Emailin e datës 25.10.2022 nga F.L për L.H; Emailin e datës 26.10.2023 nga ankuesja për L.H; Emailin e datës 31.10.2022 nga R.B për ankuesen; Emailin e datës 28.10.2022 nga E.A për N.Sh; Emailin e datës 28.10.2022 nga ankuesja për R.B dhe R.H; Emailin e datës 15.11.2022 nga R.B për L.H; Emailin e datës 14.11.2022 nga L.H për R.B; Vendimin me Nr. 6967-19 të datës 14.11.2022; Emailin e datës 15.11.2022 nga ankuesja për R.B; Vendimin Ref.02/Nr.369 të datës 16.11.2022; Vendimin A.nr.1052/2022 të KPMSHCK; Vendimin Ref.02/Nr.48 të datës 27.02.2023; Vendimin A.nr.1001/2022 të KPMSHCK; Konkursin me Nr. Reference: RN00009710 për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve; Emailin e datës 14.11.2022 nga ankuesja për K.M; Emailin e datës 31.10.2022 nga K.M për V.R-V; Emailin e datës 02.11.2022 nga B.G për ankuesen dhe të tjerët; Emailin e datës 01.11.2022 nga M.R për ankuesen dhe të tjerët; Vendimin A.nr.1033/2022 të KPMSHCK; Emailin e datës 16.05.2023 nga ankuesja për B.B dhe të tjetër; Listën e renditjes përfundimtare për pozitë Inspektor i Tregut; Konkursin me Nr. Reference: RN00011072 për pozitën Inspektor i Tregut; Emailin e datës 14.11.2023 nga ankuesja për anëtarët e Komisionit Disiplinor; Emailin e datës 28.03.2023 nga ankuesja për A.K dhe F.Z; Emailin e datës 21.09.2023 nga R.B për E.A; Emailin e datës 21.09.2023 nga E.A për R.B; Emailin e datës 20.09.2023, 12.09.2023, 03.09.2023 nga A.M për Z.D, D.L dhe ankuesen; Emailin e datës 19.09.2023 nga ankuesja për A.M; Emailin e datës 19.09.2023, 13.09.2023 nga A.M për ankuesen; Emailin e datës 21.08.2023 nga A.M për Z.D, N.B dhe ankuesen; Emailin e datës 11.08.2023 nga A.M për Z.D dhe N.B; Emailin e datës 28.07.2023 nga A.M për Z.D dhe N.B; Emailin e datës 13.11.2023 nga ankuesja për anëtarët e Komisionit Disiplinor; Emailin e datës 27.09.2023 nga B.H për ankuesen; Emailin e datës 27.10.2023 nga ankuesja për A.T, N.B dhe B.H;

Formularin për pagesë retroaktive i datës 10.10.2023; Vendimin Nr.Ref.01/69 i datës 14.09.2023; Emailin e datës 23.11.2023 nga ankuesja për anëtarët e Komisionit Disiplinor; Emailin e datës 24.12.2023 nga ankuesja për zyrtarët e KPMSHCK-së; Emailin e datës 22.12.2020, 18.12.2020 nga ankuesja për T.M dhe Rr.Z; Autorizimin e datës 17.10.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.12.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 26.12.2023; Konkursin me Nr. Reference: RN00011204 për pozitën Drejtor i Departamentit për Investime; Njoftimin e datës 29.03.2023; Emailin e datës 16.11.2023 nga K.D për D.L; Listën e pagave tetor 2023; Vendimin A.nr.352/2021 të KPMSHCK; Vendimin A.nr.323/2020 të KPMSHCK; Emailin e datës 15.11.2023 nga L.H për D.L; Emailin e datës 05.05.2023 nga ankuesja për L.H; Emailin e datës 03.05.2023 nga L.H për ankuesen; Emailin e datës 03.05.2023 nga ankuesja për F.Z; Ankesën e datës 10.10.2022 nga S.S; Vendimin me Nr. 6252/19 i datës 14.10.2022; Emailin e datës 17.11.2023 nga L.H për D.L; Emailin e datës 15.05.2023 nga L.H për R.B dhe ankuesen; Emailin e datës 28.10.2022 nga R.B për ankuesen dhe L.H; Emailin e datës 25.04.2023 nga L.H për R.B dhe ankuesen; Emailin e datës 13.04.2023 nga ankuesja për V.X; Emailin e datës 13.04.2023, 07.04.2023 nga V.X për ankuesen dhe të tjerët; Konkursin me Nr. Reference: RN00010807 për pozitën Drejtor i Departamentit të Tregtisë; Njoftimin e datës 25.09.2023; Ftesën për seancë të Komisionit Disiplinor për ankuesen e datës 09.11.2023 dhe 21.11.2023; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 10.11.2023; Vendimin Ref.02/Nr.382 i datës 08.11.2023; Vendimin Ref.02/Nr.48 i datës 27.02.2023; Vendimin Ref.03.Nr.01 i datës 19.09.2023; Vendimin Nr.02 Ref.300 i datës 30.09.2013; Kërkesë për avancim të zyrtarit e datës 30.09.2013; Pëlqim i datës 30.09.2013; Dëshmi për shpenzim të reprezentacionit datës 31.01.2023, 28.02.2023, 31.03.2023, 30.04.2023, 31.05.2023, 30.06.2023, 31.07.2023, 31.08.2023, 30.09.2023, 31.10.2023, 30.11.2023; Vendimin A.nr.327/2020 të KPMSHCK; Vendimin A.nr.331/2020 të KPMSHCK; Vendimin A.nr.333/2020 të KPMSHCK; Vendimin A.nr.322/2020 të KPMSHCK; Vendimin A.nr.334/2020 të KPMSHCK; Vendimin A.nr.329/2020 të KPMSHCK; Vendimin A.nr.324/2020 të KPMSHCK; Vendimin A.nr.330/2020 të KPMSHCK; Vendimin A.nr.325/2020 të KPMSHCK; Vendimin A.nr.328/2020 të KPMSHCK; Kërkesë sipas Qarkores Buxhetor 2021/22 e datës 24.09.2023 nga MTI për Ministrisë e Financave; Qarkoren Buxhetor 2021/22 e MTI-së; Emailin e datës 04.11.2020 nga M.B për V.R-V; Emailin e datës 04.11.2020 nga V.R-V për M.B; Vendimin A.nr.326/2020 të KPMSHCK; Ankesën me numër protokolli 7074/2023 të datës 23.11.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë e datës e datës 04.12.2023; Vendimin Ref. 02/Nr.105 të datës 10.05.2023; Diplomën me Nr. 273/3; Diplomën me Nr. 117/14; Përshkrimin e detyrave të punës së pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Licencim, Veprimtari me Naftë dhe Produkte të Naftës*; Vendimin e datës 29.12.2023 për bashkimin e procedurave (ankesave).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses, *është e bazuar, sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 974/02-KOM të datës 24.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pretendon se

Komisioni Disiplinor në seancë disiplinore nuk ka ftuar iniciuesin e procedurës disiplinore por vetëm palën ndaj të cilës është inicuar procedura disiplinore; Fillimisht është inicuar procedurë disiplinore më datë 09.10.2023 ndërkohë jashtë çdo procedure ligjore është bërë plotësimi i kërkesës për iniciimin e procedurës me një kërkesë tjetër të datës 20.11.2023 për shkelje të tjera ndërsa nuk lejohet inicim i procedurës mbi procedurën; Vendimi i Komisionit Disiplinor është nxjerr jashtë afatit të përcaktuar ligjore ngase është nxjerr në ditën e 46 nga data e inicimit të procedurës disiplinore; Veprimet ndaj ankueses janë tendencioze ngase në kohën që ka qenë duke u zhvilluar procedura disiplinore është nxjerr Vendimi i datës 08.11.2023 për transferimin e përkohshëm për gjashtë muaj. Tutje ankuesja në ankesë pretendon se pretendimet për shkelje disiplinore janë të paqëndrueshme ngase: sipas Rregullores Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore parashihet kush mund të ketë qasje në dosjet personale dhe Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë që të marr një vendim apo diçka të caktuar në dosje por asesi komplet dosjen sepse kërkesa ka qenë për komplet dosjen, kështu që nuk ka asnjë shkelje disiplinore nga ankuesja; Pretendimi për neglizhencë në procesin e zhvillimit profesional të zyrtarëve përmes planit të trajnimit është i pabazuar sepse gjithmonë janë njoftuar drejtorët dhe stafi për planin e trajnimeve më datë 31 tetor të vitit të kaluar; Pretendimi për mosbashkëpunim lidhur me iniciimin e procedurave të konkursit është i paqëndrueshëm sepse kërkesat janë dërguar por të njëjtat mbeten në faza të ndryshme të procedurës dhe janë inicuar 23 procedura rekrutimi; Lidhur me pretendimin për dosjet e personelit të Departamentit të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë është pretendim i pabazë ngase ish Sekretari i Përgjithshëm z. R.B ka kërkuar nga znj. K.K që dosjet të jenë të kompletuara dhe të njëjtat të futen në kopje fizike në SIMBNJ dhe për këtë është kërkuar raport nga znj.K.K lidhur me këtë proces; Lidhur me pretendimin e incuesit të procedurës disiplinore se ankuesja nuk ka vepruar sipas kërkesë së komisionit vlerësues duke bërë trajtim selektiv të ankesave të kandidatëve në procedurë është pretendim i pabazuar sepse nuk aludohet se për cilën procedurë bëhet fjale. Ankuesja më tej pretendon se kërkesat për iniciimin e procedurës disiplinore janë të kundërligjshme, ndërsa vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerr në kundërshtim me procedurën ligjore dhe i njëjti është i paligjshëm, duke kërkuar që ankesa të aprovohet në tersi si e bazuar, të anulohet vendimi i kundërshtuar me ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, para se të shqyrtoj lidhshmërinë e vendimit të kontestuar me ankesë, fillimisht pasqyron bazën ligjore lidhur me procedurën disiplinore e që në këtë rast aplikohen dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, mirëpo meqenëse ende nuk ka akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji në këtë aspekt, atëherë sipas nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, është përcaktuar se: *"1. Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren në afat prej një (1) viti nga hyrja në fuqi. 2. Me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij, përshtatshmërisht vlejné aktet nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë"*, mbi këtë konstatim aplikohen dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Gjatë shqyrtimit të të gjitha provave të dërguara nga palët në procedurë, gjegjësisht duke shqyrtuar provat veç e veç dhe të gjitha së bashku, e duke u ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses po ashtu pretendimeve të ngritura nga inicuesi i procedurës disiplinore e të vërtetuara nga Komisioni Disiplinor, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon se Komisioni Disiplinor në seancë disiplinore nuk ka ftuar inicuesin e procedurës disiplinore por vetëm palën ndaj të cilës është inicuar procedura disiplinore, dhe mbi bazë të provave materiale, konstaton se sipas emailit të datës 09.11.2023 dhe datës 21.11.2023 të dërguar nga znj. B.B për ankuesen e njëjta është ftuar në seancë dëgjimore të Komisionit Disiplinor për datën 10.11.2023 në orën 09:00 respektivisht për datën 22.11.2023 në orën 14:00, ndërsa sipas provave të lëndës nuk është ftuar në seancë të Komisionit Disiplinor inicuesi i procedurës disiplinore me çka është vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku ndër tjerash përcaktohet se: *"Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: Fton inicuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është inicuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit"*, prandaj Komisioni Disiplinor me këtë rast nuk ka bërë ballafaqimin e palëve në procedurë në mënyrë që të dëgjoj variantin e palëve në procedurë për çështjen e ngritur, kështu që pretendimi i ankueses është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankueses se kërkesa për plotësimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore është bërë jashtë çdo procedure ligjore për shkak që kërkesa për plotësim ka të bëjë me shkelje të tjera ndërsa nuk lejohet iniciim i procedurës mbi procedurën, Kolegji i Këshillit, konstaton se fillimisht kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses është bërë më datë 09.10.2023 me pretendimet për një mori shkeljesh të rënda disiplinore, ndërsa pas kalimit të afatit prej 30 ditësh nga dita e inicimit të procedurës disiplinore më datë 20.11.2023 është parashtruar kërkesë për plotësimin e kërkesës së datës 09.10.2023 ku është pretenduar edhe për shkelje të tjera disiplinore të bëra nga ankuesja, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se në rastin konkret plotësimi i kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore mund të bëhet vetëm në kuadër të pretendimeve të parashtruara në kërkesën e parë, gjegjësisht kjo mund të bëhet me plotësimin e provave materiale por asesi nuk mund të bëhet plotësimi i kërkesës edhe me pretendime të tjera jashtë atyre fillestare siç parashihet me nenin 93 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht në rastin konkret të ankueses, kolegji konkludon se kemi pasur të bëjmë me dy kërkesa me pretendime të ndryshme por me qëllime të njëjta, andaj në këtë rast sipas procedurave ligjore organi publik/Komisioni Disiplinor ka mundur të ndërmarr veprimet juridike për bashkimin e procedurës administrative, siç parashihet me nenin 84 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"1. Organi publik kompetent mund të bashkojë disa procedura administrative në një të vetme, nëse të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira bazohen në një gjendje faktike dhe bazë juridike të njëjtë apo të ngjashme. 2. Bashkimi i procedurave nuk kufizon të drejtën e palëve për të paraqitur kërkesa apo pretendime të ndryshme"*, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi i ankueses është i bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankueses e cila pretendon se Vendimi me numër protokoll 974/02-KOM i datës 24.11.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është nxjerr jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se sipas Vendimit Ref.02/Nr.339 me numër protokoll 772/02 të datës 09.10.2023 është formuar Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, mirëpo më datë 24.10.2023 zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka nxjerr Vendim Ref.02/Nr.356 me të cilin ka formuar Komisionin Disiplinor duke bërë shfuqizimin e Vendimit Nr. 772/02 të datës 09.10.2023, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton faktin se ndryshimi i Komisionit Disiplinor është bërë pa ndonjë arsye, ngase në vendimin e datës 24.10.2023 nuk është dhënë asnjë arsye pse është shfuqizuar vendimi i datës 09.10.2023, respektivisht nuk janë dhënë arsye nëse janë plotësuar kushtet ligjore për ndryshimin e Komisionit Disiplinor të parashikuar me nenin 10 paragrafi 4 dhe 5 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Kolegji i Këshillit konstaton se ndryshimi i Komisionit Disiplinor është bërë në kohën sa rasti i ankueses ka qenë i proceduar pranë Komisionit Disiplinor të emëruar sipas vendimit të datës 09.10.2023, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimin e ankueses ju referua procesverbalit të seancës së Komisionit Disiplinor të datës 22.11.2023, ku përfaqësuesi i ankueses ka ngritur shqetësimin se vendimmarrja në këtë proces ka tejkaluar të gjitha afatet ligjore, ndërsa kryesuesja e Komisionit Disiplinor të emëruar sipas vendimit të datës 24.10.2023 ka theksuar se është brenda afatit ngase lëndën e ka pranuar më datë 26.10.2023, mirëpo Kolegji i Këshillit, konstaton se afati procedural për shqyrtimin e kërkesës rrjedhë nga koha kur organi publik gjegjësisht Komisioni Disiplinor ka pranuar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore konkretisht afati ka filluar të rrjedh nga data 09.10.2023 kur është parashtruar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore, kështu që meqenëse në këtë procedurë kemi pasur rrethana të reja ndryshim të Komisionit Disiplinor (edhe pse nuk ka plotësuar kushtet ligjore për ndryshim), atëherë ky organ ka pasur kompetencë që për shkak të kompleksitetit të vendos për shtyrjen e afatit për përçudnimin e procedurës administrative siç parashihet me nenin 99 të Ligjit me Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mirëpo një gjë e tillë sipas provave të lëndës nuk ka ndodhur, ngase përmes kërkesës për përgjigje në ankesë është kërkuar vendimi për shtyrjen e afatit të procedurës mirëpo nuk është dërguar. Kolegji i Këshillit, bazuar në konstatimin si më lartë dhe duke marr për bazë iniciimin e procedurës disiplinore të datës 09.10.2023, dhe datën e nxjerrjes së Vendimit me numër protokoll 974/02-KOM të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, konstaton se ky vendim është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë me të cilin është përcaktuar se: *"Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për iniciim të procedurës nga njësia për burime njerëzore"*, ngase ndryshimi i Komisionit Disiplinor nuk është arsye ligjore që vendimmarrja të jetë jashtë afatit procedural, kështu që pretendimi i ankueses është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankueses se veprimet ndaj saj janë tendencioze ngase në kohën që ka qenë duke u zhvilluar procedura disiplinore është nxjerr Vendimi Ref.02/Nr.382 i datës 08.11.2023 për transferimin e përkohshëm për gjashtë muaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se në kohën kur ka qenë duke u zhvilluar procedura disiplinore ndaj ankueses pranë Komisionit Disiplinor, zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 08.11.2023 ka nxjerr Vendimin Ref.02/Nr.382 për transferimin e përkohshëm të ankueses në pozitën *“Udhëheqës i Divizionit për Licencim, Veprimtari me Naftë dhe Produkte të Naftës”* në Departamentin e Rregullimit të Tregut të Naftës për gjashtë muaj, të cilin ankuesja e ka kundërshtuar përmes ankesës me numër protokolli 7074/2023 të datës 23.11.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mirëpo duke parë ndërlidhmërinë e ankesave atëherë është bërë bashkimi i tyre. Nisur nga natyra juridike e rastit të ankueses, Kolegji i Këshillit, konstaton se në rast të inicimit të procedurës disiplinore ndaj nëpunësit civil nuk mund të merren veprimet juridike nga një organ tjetër brenda institucionit të njëjtë për shkak që do të paraqiste një tendencë ndaj organit që është duke e shqyrtuar rastin e inicimit të procedurës disiplinore, respektivisht në rastin konkret të ankueses transferimi i saj çoftë përmes vendimit të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm apo edhe vendimit të Komisionit Disiplinor është bërë në klasë dhe kategori të njëjtë, si rezultat i kësaj, Kolegji konstaton se vendimi i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm i ka paraprirë masës disiplinore, në këtë rast nuk është dashur të ndërmerret asnjë veprim ndaj ankueses, ngase do të merrej si pretekst ndërhyrja në punën e Komisionit Disiplinor, respektivisht kur procedura inicohet pran një organi publik në këtë rast pranë Komisionit Disiplinor të gjitha përgjegjësit bien në juridiksionin e këtij organi, ku sipas dispozitave ligjore Komisioni Disiplinor ka pasur kompetencë që të ndërmarr veprimet e tjera të parapara me nenin 59 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë. Andaj nisur nga kjo gjendje faktike dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Kolegji konstaton se Vendimi Ref.02/Nr.382 i datës 08.11.2023 i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm është vendim i pabazuar në përmbajtje dhe i cili ka penguar procedurën disiplinore, kështu që si i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë ngase cenon parimin e sigurisë juridike, kështu që pretendimi i ankuese ndaj këtij vendimin është i bazuar.

Lidhur me pretendimet e inicuesit të procedurës disiplinore e të cilat janë konfirmuar nga Komisioni Disiplinor, Kolegji i Këshillit, konstaton se është fakt i pakontestueshëm që Zyrtarja e Lartë Ekzekutive pranë Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm përmes emailit të datës 19.06.2023 me kërkesë të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm ka kërkuar nga ankuesja të sjell dosjen personale të znj. K.T tek zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm, ndërsa ankuesja përmes emailit të datës 19.06.2023 ka kërkuar që kërkesa të argumentohet ngase duhet plotësuar kushtet e parashikuar me nenin 5 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes se Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje ju referua Rregullores Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes se Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

gjegjësisht nenit 5 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5, ku përcaktohet se: "1. Dosja personale e zyrtarëve publikë është konfidenciale dhe qasja në të është e ndaluar. 2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni qasje të plotë në dosjet personale të zyrtarëve publikë kanë: 2.1. Zyrtari publik në dosjen e tij personale; 2.2. Personi i autorizuar i njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (NJBNI) të institucionit përkatës, dhe; 2.3. personi i autorizuar nga ministria përgjegjëse për administratën publike, që administron SIMBNI-në. 3. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni qasje të kufizuara në dosjet personale të zyrtarëve publikë kanë anëtarët e komisioneve disiplinore, përfaqësuesit e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, organet kompetente të gjyqësorit dhe qdo organ tjetër i autorizuar me ligj. 4. Në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, të gjitha kategoritë e parapara duhet të dorëzojnë kërkesën e argumentuar për qasje në dosjet personale të zyrtarëve publikë. 5. Lejimi i qasjes në dosjen e personale sipas paragrafit 4 të këtij neni lejohet me aprovimin e kërkesës nga drejtuesi i njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës", si rezultat i këtyre dispozitave Kolegji i Këshillit, konstaton se kërkesa e zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm nuk ka qenë e argumentuar dhe nuk ka qenë e specifikuar lidhur me aktet të cilat kërkohen, kështu që marr për bazë këtë kërkesë rezulton se është kërkuar e tërë dosje e kësaj nëpunëseje, ndërsa ankuesja përmes emailit të datës 19.06.2023 ka kërkuar që kërkesa të argumentohet, mirëpo edhe përkundër kësaj nuk është bërë argumentimi i saj, si rrjedhojë ankuesja ka vepruar në pajtim me paragrafin 5 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, kështu që ankuesja nuk ka bërë shkelje ligjore në këtë çështje gjegjësisht ka vepruar në pajtim me nenin 26 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ngase në këtë kohë ka qenë i zbatueshëm ky ligj.

Lidhur me pretendimin e inicuesit të procedurës disiplinore për neglizhencë të ankueses në procesin e zhvillimit profesional të zyrtarëve përmes planit të trajnimit, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës, konstaton se për vitin 2023 Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka përgatitur Planin Individual të Personelit ku përfshihet edhe plani i trajnimeve bazuar në nenin 15 të Ligjit të aplikuar Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (MPB) Nr. 02/2020 për Planifikimin e Personelit, rrjedhimisht sipas procedurave ligjore nëpunësit para përgatitjes së planit të përgjithshëm të personelit vetë plotësojnë planin individual të trajnimeve ku në bashkëpunim me mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë paraqesin nevojat e trajnimeve dhe fushën e trajnimeve, ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka përgjegjësi që planin individual të trajnimeve të inkorporoj në planin e përgjithshëm të personelit. Kolegji i Këshillit duke u bazuar në provat materiale të lëndës, ka gjetur se ankuesja si provë materiale ka dërguar ftesat për trajnimet e organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për vitin 2023, duke bashkangjitur të gjitha komunikimet që ankuesja ka bërë me nëpunësit e niveleve drejtuese lidhur me trajnimet që organizohet nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për nëpunësit civil, gjegjësisht Kolegji ka gjetur se ky komunikim ka filluar sipas emailit të datës 27.02.2023, datës 06.03.2023, datës 20.03.2023, datës 22.03.2023, datës 23.03.2023, datës 28.03.2023, datës 03.04.2023, datës 04.04.2023, datës 07.04.2023, datës 08.04.2023, datës 14.04.2023, datës 19.04.2023, datës 28.04.2023, datës 03.05.2023, datës 04.05.2023, datës 05.05.2023, datës 08.05.2023, datës 10.05.2023, datës 11.05.2023, datës 12.05.2023, datës 17.05.2023, datës 18.05.2023, datës 19.05.2023, datës 23.05.2023, datës 24.05.2023, datës 26.05.2023, datës 29.05.2023, datës 06.06.2023,

datës 08.06.2023, ku në këto emaila ka qenë i përfshirë edhe zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm me çka ka qenë i njoftuar për të gjitha trajnimet që është dërguar ftesa nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike, mbi këto konstatime nuk qëndron pretendimi i inicuesit të procedurës disiplinore se ankuesja ka neglizhuar procesin e menaxhimit të zhvillimit profesional të zyrtarëve.

Inicuesi i procedurës disiplinore pretendon se ankuesja nuk ka bashkëpunuar me agjencitë/departamentit lidhur me iniciimin e procedurave të konkursit, ndërsa Kolegji i Këshillit në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se sipas Planit Individual të Personelit janë paraparë një mori pozitash të të gjitha kategorive duke filluar nga pozita e Sekretarit të Përgjithshëm e deri tek pozita e klasës më të ulët profesionale, dhe mbi bazë të këtij plani janë paraparë edhe mënyra e përmbushjes së këtij planifikimi. Rrjedhimisht Kolegji sipas provave të lëndës, konstaton se gjatë vitit 2023 janë hapur gjithsej 23 procedura të lëvizjes brenda kategorisë apo edhe ngritjes në detyrë, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka ndërmarr të gjitha veprimet për shpalljen e konkurseve, mirëpo Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore nuk është përgjegjëse dhe nuk varet nga kjo njësi nëse konkurset do të jenë apo jo të suksesshme, ngase Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka kompetencë të bëjë vetëm verifikimin paraprak të kandidatëve siç parashihej me dispozitat e Ligjit të aplikuar Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa fazat tjera të procedurave janë në kompetencë të Komisioneve Vlerësuese për Lëvizje Brenda Kategorisë apo të Komisioneve Vlerësuese të Ngritjes në Detyrë siç parashihet me dispozitat e rregullores së lartcekur, andaj Kolegji i Këshillit, konstaton faktin se dështimi i procedurave për shkak të mos aplikimit të kandidatëve, mos plotësimit të kushteve të parapara për pozitën përkatëse, apo edhe mos arritjes së numrit të kandidateve fitues, nuk mund të jetë dështim i Udhëheqësit të Njëjesisë së Burimeve Njerëzore në këtë rast ankueses, ngase vlerësimi i procedurave dhe suksesi në fund të proceseve të regrutimit është i ndërlidhur me disa organe, për më tepër për pozitat që nuk janë plotësuar sipas konkursit përmes lëvizjes brenda kategorisë apo edhe ngritjes në detyrë, duhet të zhvillohen procedura e pranimi e për këtë është përgjegjës Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme si njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, ndërsa përmes emailit të datës 16.05.2023 dërguar për zyrtarët e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme duke kërkuar iniciimin e procedurës së jashtme për pozitën Inspektor i Tregut. Nga konstatimet si më sipër Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja nuk është përgjegjëse për konkurset e dështuara brenda ministrisë, ngase ankuesja ka përmbushur detyrat e saj dhe ka vepruar sipas kërkesave që ka pranuar dhe e njëjta i ka proceduar sipas procedurave ligjore në fuqi.

Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon se nuk ka bërë asnjë shkelje ligjore lidhur me mos sigurimin e dosjeve të personelit të Departamentit të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, dhe në bazë të provave materiale konstaton se zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë z. R.B, përmes emailit të datës 03.02.2023 ka kërkuar nga znj.

K.K që të fillohet me procedurat e dorëzimit të dosjeve e të zyrtarëve të ish Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa tutje përmes këtij emaili është kërkuar nga znj. K.K që pa u bërë vendosja/harmonizimi në sistem sipas kopjeve fizike të dosjeve të çdo zyrtari Komisioni nuk mund të pranoj dorëzimin e dosjeve, kështu që është kërkuar që ky proces të finalizohet sa më shpejt, po ashtu në vazhden e këtij procesi z.R.B përmes emailit të datës 06.03.2023 dhe emailit të datës 12.04.2023 ka kërkuar nga znj. K.K se a ka përfunduar ky proces respektivisht a janë dorëzuar dosjet. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit nga provat e dërguara nga palët në procedurë nuk është argumentuar se znj. K.K të jetë përgjigjur në ndonjë nga emailt e zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë z. R.B, gjegjësisht sipas këtyre emaileve ankuesja në asnjërën prej tyre nuk ka qenë e përfshirë apo njoftuar, kështu ankuesja nuk mund të bëhet përgjegjëse për një gjë të tillë dhe i cili proces nuk është varur ekskluzivisht nga ankuesja.

Lidhur me pretendimin e inicuesi të procedurës disiplinore se ankuesja nuk ka vepruar sipas kërkesës së komisionit vlerësues duke bërë trajtim selektiv të ankesave të kandidatëve në procedurë, Kolegji i Këshillit konstaton se ky pretendim i inicuesit të procedurës disiplinore është pretendim i përgjithshëm dhe nuk specifikon ndonjë procedurë konkrete, mirëpo që Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në seancën disiplinore të datës 22.11.2023 dhe vendimin e datës 24.11.2023 ju referohet konkursit për pozitën Inspektor i Tregut gjegjësisht ankesës së një kandidati në këtë procedurë z. S.S. Kolegji i Këshillit, thekson se lidhur me këtë proces dhe procedimin e ankesës së këtij kandidati, Vendimin me numër protokollit 6967-19 të datës 14.11.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë dhe Vendimin Ref.02/Nr.369 të datës 16.11.2022 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm është vendosur fillimisht sipas Vendimit me numër A.nr.1001/2022 të datës 27.12.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku është refuzuar ankesa e datës 11.11.2022 e ankuesit S.S, ndërsa është lënë në fuqi njoftimi i datës 18.10.2022 për kandidatin fitues, ndërsa sipas Vendimit me numër A.nr.1052/2023 të datës 30.12.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është aprovuar ankesa e kandidatit fitues F.L duke u shfuqizuar Vendimi me numër protokollit 6967-19 i datës 14.11.2022 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë dhe Vendimi Ref.02/Nr.369 i datës 16.11.2022 i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe është lënë në fuqi Akt Emërimi i datës 24.10.2022 për këtë kandidatë dhe njoftimin për kandidatin fitues i datës 18.10.2022. Prandaj nisur nga ky vlerësim Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja nuk mund të bëhet përgjegjëse për shkelje të tilla, ngase sipas vendimeve të lartcekura të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është konstatuar ndonjë kundërligjshmëri në këtë procedurë dhe ankuesja nuk ka bërë asnjë shkelje në këtë proces, andaj marrja e veprimeve përtej vendimeve përfundimtare në procedurë administrative vetëm e vetëm për të bërë përgjegjës një person është kundërligjshmëri e bërë nga inicuesi i procedurës disiplinore dhe Komisioni Disiplinor, kështu që pas dështimit të konkursit për lëvizje brenda kategorisë për pozitë Inspektor të Tregut ankuesja në cilësinë e Udhëheqëses së Divizionit të Personelit më datë 16.05.2023 ka bërë kërkesë tek zyrtarët e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të

Ministrisë së Punëve të Brendshme që të fillohet me procedurën e jashtme-pranimit për këtë pozitë, si rezultat i kësaj, Kolegji, konstaton se ankuesja ka kryer obligimet e saja ligjore lidhur me këtë proces.

Sa i përket pretendimit të inicuesit të procedurës disiplinore se ankuesja ka nxjerr informacione të brendshme për kandidatët e jashtëm të cilat informata kandidatët i kanë përmendur në ankesat e parashtruara në KPMSHCK, Kolegji i Këshillit, konstaton se inicuesi i procedurës disiplinore nuk i referohet ndonjë rasti konkret, por edhe nëse do të ishte referuar ndonjë rasti konkret nuk ka mund të argumentoj me asnjë prove materiale se ankuesja ka nxjerr informacione jashtë institucionit për shkak që ky pretendim nuk është argumentuar as nga Komisioni Disiplinor por nuk ka pasur asnjë vendim të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që ka konstatuar një gjë të tillë, andaj pretendimi për një shkelje të tillë i inicuesit të procedurës disiplinore është i papabazuar.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin e inicuesit të procedurës disiplinore i cili pretendon se ankuesja ka bërë aprovimin e pushimeve mjekësore/lëndime profesionale pa ndonjë bazë ligjore për zyrtarin z.A.M dhe zyrtarët e tjerë, konstaton se është fakt i pa kontestuar se zyrtari A.M më datë 12.09.2023 përmes emailit dërguar Z.D, D.L dhe ankuses, kërkon që për shkak të sëmundjes profesionale që të njoftohet me procedurat tjera e duke kërkuar që të ndihmohet financiarisht nga institucioni sikurse në rastet e tjera, ndërsa ankuesja përmes emailit të datës 13.09.2023 njofton zyrtarin A.M se pas përfundimit të pushimit mjekësor të rregullt njëzet ditë, juve do t'ju përgatitet vendimi për pushimin mjekësor me 70% e pagës deri në tre muaj meqë sëmundja juaj kërkon trajtim mjekësor dhe rehabilitim pas operimit, ndërsa përmes emailit të datës 19.09.2023 zyrtari A.M njoftohet nga ankuesja se vendimin për pushim mjekësor me 70% e pagës është përgatitur dhe gjendet në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm për miratim. Po ashtu nuk është kontestuese se përmes emailit të datës 20.09.2023 zyrtari A.M ka kërkuar nga Z.D dhe D.L, që të aprovohet kërkesa për pushim me 70% të pagës deri në 90 ditë për shkak të lëndimit profesional, ndërsa nga zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes emailit të datës 21.09.2023 është kërkuar nga Departamenti Ligjor i kësaj ministrie të jep një opinion ligjor lidhur me kërkesën e z. A.M, ndërsa Drejtori i Departamentit Ligjor më datë 21.09.2023 njofton se sipas legjislacionit në fuqi lejohet me marr pushim 70% të pagës për tre muaj, si rrjedhojë sipas këtij opinionioni zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 21.09.2023 ka nxjerr Vendimin Ref.02/Nr.313 përmes të cilën zyrtarit A.M i lejohet pushimi mjekësor me kompensim prej 70% të pagës në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditë dhe atë nga data 18.09.2023 deri më datë 17.12.2023 ndërsa sipas Vendimit Ref.02/Nr.462 të datës 19.12.2023 të organit të njëjtë është bërë plotësim ndryshimi i vendimit paraprak dhe është shtuar prapashtesa *pune* si në pikën 2 të këtij vendimi, ndërsa sipas pikë 3 të këtij vendimi pushimi mjekësor fillon më datë 18.09.2023 ndërsa përfundon më datë 25.01.2024. Bazuar në këtë gjendje të fakteve, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja në asnjë formë nuk ka bërë aprovimin e pushimit mjekësor për këtë zyrtar, ngase është kërkuar opinion ligjor për këtë çështje nga Departamenti Ligjor (i cili është nën vartësin e Sekretarit të Përgjithshëm) dhe vetëm pas këtij opinionioni është lëshuar

vendimi nga zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja nuk ka nënshkruar asnjë dokument përmes të cilit zyrtarit A.M i ka lejuar pushimin mjekësor kompensim prej 70% të pagës në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditë, kështu që nuk mund të bëhet përgjegjës për një gjë të tillë, po ashtu organi i punësimit gjegjësisht Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me asnjë provë nuk ka argumentuar që ankuesja ka lejuar pushime të tilla për zyrtarët e tjerë ngase ky është edhe pretendim i inicuesit të procedurës disiplinore.

Lidhur me pretendimet e inicuesit të procedurës disiplinore se ankuesja ka nxjerr vendime për transfer të përkohshëm të zyrtarëve pa njoftim paraprak edhe pse për një gjë të tillë është njoftuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, Kolegji i Këshillit, konstaton se inicuesi i procedurës disiplinore nuk ka specifikuar ndonjë rast konkret lidhur me këtë çështje por vetëm ka pretenduar në mënyrë të përgjithshme. Lidhur me pretendimin e inicuesit të procedurës disiplinore i cili pretendon se ankuesja nuk ka vepruar lidhur me vendimin e Këshillit të Pavarur për rastin e I.E dhe vendimeve të tjera të Këshillit të Pavarur, Kolegji i Këshillit, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 14.06.2021 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.352/2021 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit I.E duke lënë në fuqi Akt Emërimin e datës 09.07.2012 të këtij ankuesi i cili mban pozitën Udhëheqës i Divizionit të Metrologjisë, ndërsa ka anuluar Vendimin me numër protokollit 02/1023 të datës 01.10.2013 të nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si rrjedhojë për këtë vendim ankuesja nuk ka pasur asnjë obligim për zbatim, konkretisht nuk mund të konsiderohet se ka kryer shkelje disiplinore. Sa i përket pretendimit të inicuesit të procedurës disiplinore se ankuesja ka bërë shkelje disiplinore kur ka bërë paraqitjen në listën e pagave të stafit të Kabinetit të Ministres në kategorinë shtesa për kompensim jashtë orarit të punës edhe pse një gjë e tillë nuk qëndron për shkak se nuk është parashtruar kërkesë për kompensim shtesë, Kolegji i Këshillit konstaton se inicuesi ka pretenduar për stafin e kabinetit që nënkupton nuk ka pretenduar për një zyrtar të stafit por për më shumë, ndërsa në bazë të provave të lëndës rasti është identifikuar vetëm për Këshilltarin e Lartë Politik K.D, ndërsa ankuesja përmes emailit të datës 27.10.2023 dërguar për zyrtarët e Thesarit të Kosovës thekson me t'u shkarkuar lista e pagave janë hasur disa lëshime duke kërkuar që këto gabime të evitohen para se të jetë lista përfundimtare, ku sipas provave të lëndës Këshilltari i Lartë Politik K.D nuk ka mundur të kyqet në sistem të pagave dhe për këtë më datë 10.10.2023 është proceduar për pagesë retroaktive në Thesarin e Kosovës dhe askund nuk figuron që kompensimi duhet të bëhet për punë jashtë orarit, ndërsa sipas emailit të ankueses drejtuar zyrtarëve të Thesarit të Kosovës rezulton se në listë të pagave figuron si punë jashtë orarit. Për rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se kompensimi për këtë zyrtar nuk është dërguar në Thesarin e Kosovës si kompensim i punës jashtë orarit por gabimi ka qenë nga Thesari i Kosovës kur është publikuar lista e pagave, kështu që ankuesja nuk ka bërë ndonjë shkelje ligjorë lidhur me këtë çështje.

Sa i përket pretendimit për moszbatim të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës gjegjësisht Vendimit A.nr.323/2020, Kolegji i Këshillit,

konstaton se nuk është evidentuar ndonjë moszbatim i vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e të cilin ankuesja në cilësinë e Udhëheqëses së Divizionit të Personelit nuk e ka zbatuar, ngase nëse do të kishte ndonjë vendim të pazbatuar atëherë do të ndërmerreshin veprimet në kuadër të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës gjegjësisht sipas nenit 23 dhe 24, kështu që nuk qëndron pretendimi se ankuesja nuk ka zbatuar vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Nga konstatimet si më lartë e që ndërlidhen me kërkesën e datës 09.10.2023 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses dhe kërkesës së datës 20.11.2023 për plotësimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 09.10.2023, Kolegji i Këshillit, konstaton se inicuesi i procedurës disiplinore në disa prej pretendimeve të tij siç është përmendur edhe më lart nuk ju ka referuar rasteve konkrete por ka pretenduar në mënyrë të përgjithshme pa dhënë arsyet të qarta dhe konkrete duke mos i argumentuar me prova materiale, si rrjedhojë Kolegji, konstaton se këto kërkesa nuk plotësojnë kushtet ligjore të parapara me nenin 6 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ndërlidhur me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative që kanë të bëjnë me parashtrimin e kërkesave.

Duke qenë se vendimi i kundërshtuar me ankesë gjegjësisht Vendimi me numër protokolli 974/02-KOM i datës 24.11.2023 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është përfshirë me shkelje të dispozitave procedurale siç është potencuar edhe më lartë për shkak që i njëjti është nxjerr jashtë afatit prej 30 ditësh, po ashtu ky vendim është përfshirë edhe në shkelje materiale, ngase masën disiplinore ndaj ankueses e ka shqiptuar mbi konstatimin se ankuesja në cilësinë e Udhëheqëses së Divizionit të Personelit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka kryer shkelje të rënda disiplinore të parapara me nenin 56 paragrafi 4 dhe nenin 57 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndërsa ky ligj nuk ka qenë në fuqi në kohën për të cilën është bërë përgjegjës ankuesja, sepse në kohën për të cilën ankuesja është shpall përgjegjës për shkelje disiplinore ka qenë në fuqi Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që Kolegji i Këshillit konstaton se procedura disiplinore nuk mund të veprojë në mënyrë retroaktive. Andaj Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh konstatimet si më sipër, konstaton se Vendimi me numër protokolli 974/02-KOM i datës 24.11.2023 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është nxjerr në kundërshtim me nenin 55, nenin 56 paragrafi 4, nenin 57 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3, nenin 61 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe dispozitave të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, po ashtu ky vendim është nxjerr pa një konstatim të drejtë të gjendjes faktike dhe pa u mbështetur në provat materiale duke vepruar në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që si rezultat i këtyre shkeljeve, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër protokolli 974/02-KOM i datës 24.11.2023 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5, 1.6 dhe

1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankueses për kundërligjshmëri të këtij vendimi janë të bazuara.

Bazuar në at që u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është i obliguar që ankuesen ta kthejë në vendin e punës në pozitën *Udhëheqëse e Divizionit të Personelit* sipas Akt Emërimit të datës 30.01.2012 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me marrëdhënien e punës, duke bërë heqjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankueses.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1522/2023, datë 05/01/2024.

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses, Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.